



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Adresa: Rr. "Abdi Toptani", ish-hotel "Drini", Tiranë

Tel 04 22268141; 22268142

Nr. 83/6 Prot.

Tiranë, më 13.07.2017

V E N D I M

Nr.161, datë 13/07/2017

"Mbi përfundimin e procesit të verifikimit të zbatimit të Vendimit të Komisionerit Nr. 101, datë 13.09.2016, dhe ligjshmërisë së veprimeve administrative të kryera gjatë procesit të emërimeve nga institucioni i Agjencisë Kombëtare të Bregdetit, prej datës 01.03.2016 e në vazhdim"

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, dhe Rregulloren, "Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit", miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të relacionit dhe mendimit paraprak të Drejtorisë së Çështjeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë, në lidhje me verifikimin e zbatimit të Vendimit të Komisionerit Nr. 101, datë 13.09.2016, "Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së përgjithshme në institucionin, Agjencia Kombëtare e Bregdetit", në institucionin Agjencia Kombëtare e Bregdetit,

VËREJ SE:

Me Vendimin Nr. 16, datë 03.02.2016, "Për kryerjen e mbikëqyrjes në lidhje me zbatimin e ligjit në procesin e administrimit të shërbimit civil në Agjencinë Kombëtare të Bregdetit". Ky proces është përmbyllur me Vendimin Nr. 101, datë 13.09.2016, "Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së përgjithshme në institucionin Agjencia Kombëtare e Bregdetit" të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në të cilin është vendosur:

1. Të miratoj raportin përfundimtar të mbikëqyrjes së përgjithshme në lidhje me administrimin e shërbimit civil në institucionin, Agjencia Kombëtare e Bregdetit, i cili është pjesë e këtij vendimi.
2. Njësia përgjegjëse (DAP), të revokojë aktet e deklarimit të statusit të punësimit, të cilat kanë dalë në kundërshtim me ligjin, si dhe të ndërpresë marrëdhënien e punës, në përputhje me kërkesat e nenit 67, të ligjit për nëpunësin civil, si dhe të akteve nënligjore që rregullojnë këtë proces (VKM nr. 116, "Për statusin e nëpunësve dhe punonjësve aktualë...", i ndryshuar), për rastet si më poshtë:

- Të revokohet akti nr. 3302/4, datë 30.10.2014, i Departamentit të Administratës Publike, që deklaroi punonjësen ***** si nëpunës civil në periudhë prove, në pozicionin “Specialist në Sektorin e Zhvillimit Detar dhe Bregdetar” dhe të përfundojë marrëdhënia e punës me institucionin, në përputhje me kërkesat ligjore;
- Të revokohet akti nr. 3302/10, datë 30.10.2014, i Departamentit të Administratës Publike, që deklaroi punonjësen *****, si nëpunës civil në periudhë prove, në pozicionin “Specialist Arkiv Protokoll, Burime Njerëzore” dhe të përfundojë marrëdhënia e punës me institucionin, në përputhje me kërkesat ligjore;
- Të revokohet akti nr. 3302/8, datë 30.10.2014, i Departamentit të Administratës Publike, që deklaroi punonjësin *****, si nëpunës civil në periudhë prove, në pozicionin “Specialist, Dega Rajonale Durrës” dhe të përfundojë marrëdhënia e punës me institucionin, në përputhje me kërkesat ligjore;
- Të revokohet akti nr. 3302/3, datë 30.10.2014, i Departamentit të Administratës Publike, që deklaroi punonjësen *****, si nëpunës civil në periudhë prove, në pozicionin “Specialist, Dega Rajonale Durrës” dhe të përfundojë marrëdhënia e punës me institucionin, në përputhje me kërkesat ligjore;
- Të revokohet akti nr. 3302/5, datë 30.10.2014, i Departamentit të Administratës Publike, që deklaroi punonjësen *****, si nëpunës civil në periudhë prove, në pozicionin “Përgjegjës Sektori në Drejtorinë e Planifikimit Territorial dhe Menaxhimit të Zonave Bregdetare”, si dhe aktin nr. 4253/1, datë 25.09.2015, të Departamentit të Administratës Publike, që transferon këtë punonjëse në pozicionin “Titullar, në Dega Rajonale Sarandë” dhe të përfundojë marrëdhënia e punës me institucionin, në përputhje me kërkesat ligjore.

Njësia përgjegjëse, të kujdeset që këto pozicione, t'i shpallë vende vakante dhe t'i plotësojë nëpërmjet procedurës së konkurrimit të hapur, apo lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë, sipas rastit, në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe akteve nënligjore, dalë në bazë e për zbatim të tij.

3. Për rregullimin e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil në rastin e punonjësës ***; të veprohet si më poshtë :**

- Të revokohet akti nr. 92/2, datë 08.02.2016, i titullarit të institucionit, “Për lirim nga shërbimi civil”, për punonjësen *****, si akt absolutisht i pavlefshëm.
- Njësia e burimeve njerëzore, të drejtojë procesin, duke u kujdesur që, personat e ngarkuar me ligj për kryerjen e procesit të vlerësimit të rezultateve individuale në punë, në periudhë prove, për nëpunësen *****, të revokojnë “Formularin e vlerësimit”, të periudhës së provës, Janar 2015 - Janar 2016.
- Të bëhet rivlerësimi i kësaj nëpunëseje për periudhën e provës, në mënyrë objektive dhe të plotë, duke respektuar përcaktimet ligjore të nenit 62, të ligjit 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe të Vendimit nr. 109, datë 26.02.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë”, si më poshtë:

- *Procedura e vlerësimit të rezultateve në punë duhet të respektojë të gjitha fazat përkatëse të vlerësimit si planifikimin, bisedimet e ndërmjetme dhe vlerësimin përfundimtar, duke u shoqëruar me dokumentacionin përkatës që materializon zhvillimin e këtyre fazave.*
 - *Njëkohësisht formulari i vlerësimit duhet të përmbajë komentet përkatëse në të gjitha rubrikat e saj, për të identifikuar aftësitë dhe dobësitë e nëpunësit civil, për të cilin bëhet vlerësimi, në mënyre që të sugjerohen trajnime dhe mundësi të tjera, për zhvillimin profesional të nëpunëses *****.*
- *Të revokohet akti i titullarit të institucionit të mbikëqyrur, nr. 6, datë 03.02.2016, “Për moskonfirmimin e statusit të nëpunësit civil të *****”, si akt absolutisht i pavlefshëm, i nxjerrë në kundërshtim me formën dhe procedurën e kërkuar nga ligji.*
4. *Njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore të institucionit të mbikëqyrur, të plotësojë dosjet e personelit të çdo nëpunësi civil, sipas detyrave konkrete që janë lënë në Kapitullin nr. 9, të raportit përfundimtar të mbikëqyrjes, që do të jetë pjesë e këtij vendimi, si dhe të administrojë në dosjen e personelit dokumentet që mungojnë, të evidentuara në aneksin përkatës, që është pjesë e raportit.*
5. *Njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore të institucionit të mbikëqyrur dhe njësia përgjegjëse (DAP), të marrin masat, sipas orientimeve që janë dhënë në kapitullin ku janë trajtuar dosjet e personelit, për të plotësuar dosjen e punonjësit *****, duke pasur parasysh edhe detyrimin që ka punonjësi në këtë rast, sipas lidhjes nr. 1, pika 3, germa “b”, të Vendimit nr. 117, datë 05.03.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit”, për të dorëzuar të gjitha të dhënat që provojnë edukimin e tij arsimor, të tilla si “Diploma e shkollës së lartë, lista e notave”, ose një dokument të barasvlershëm me diplomën, në formën e vërtetimit të lëshuar nga institucioni përkatës për arsimin e lartë, sipas përcaktimeve të nenit 91, pika 4, të ligjit nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”.*
6. *Për kryerjen e këtyre veprimeve administrative, lihet afat **60** ditë nga marrja dijeni për këtë vendim. Subjekti i mbikëqyrur, Agjencia Kombëtare e Bregdetit dhe njësia përgjegjëse (DAP) duhet të zbatojnë këtë vendim duke u bazuar në rekomandimet e dhëna në përmbajtjen e raportit.*

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, me qëllim verifikimin e zbatimit të detyrave të lëna në Vendimin paralajmërues nr. 101, datë 13.09.2016, të Komisionerit, si dhe verifikimin e ligjshmërisë së veprimeve administrative të kryera gjatë realizimit të procedurave për rekrutim, transferim, ngritje në detyrë, në institucionin e Agjencisë Kombëtare të Bregdetit, prej datës 01.03.2016 që është momenti i verifikimit të kryer në kuadër të mbikëqyrjes e në vazhdim, me vendimin nr. 12, datë 08.02.2017, “Për verifikimin e zbatimit të vendimit të Komisionerit nr. 101, datë 13.09.2016 dhe ligjshmërinë e veprimeve administrative të kryera nga institucioni i Agjencisë Kombëtare të Bregdetit, gjatë procesit të emërimeve, të kryera prej datës 01.03.2016 e në vazhdim”, ka vendosur fillimin e verifikimit të zbatimit të Vendimit nr. 101 datë 13.09.2016, “Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së përgjithshme në Institucionin e Agjencisë Kombëtare të Bregdetit”.

Për këtë qëllim u ngrit grupi i punës, me përbërje Altin Shumeli, Drejtor i Mbikëqyrjes, Saimir Muçmataj, Inspektor në Drejtorinë e Mbikëqyrjes dhe Helga Peti, Specialiste në Drejtorinë e Çështjeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë, të cilët në datën 09.02.2017, u paraqitën pranë institucionit të Agjencisë Kombëtare të Bregdetit.

Verifikimi u realizua nëpërmjet vizitës në institucionin e Agjencisë Kombëtare të Bregdetit, dhe subjekti u njoftua për fillimin e procesit me shkresën nr. 83/2 prot., datë 09.02.2017 “Njoftim për fillimin e verifikimit”.

Gjatë vizitës në subjekt më datë 23.02.2017, grupi i punës komunikoi me njësinë e menaxhimit të burimeve njerëzore dhe verifikoi materialet shkresore të cilat vërtetonin zbatimin e detyrave të lëna nga Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil në vendimin paralajmërues. Takimi me njësinë e burimeve njerëzore, si dhe verifikimi i akteve dhe dokumentacionit shoqëruar që administrohej nga kjo zyrë dhe zyra e Arkiv-Protokollit, është materializuar në procesverbalin dt. 23.02.2017, të mbajtur nga grupi i punës i Komisionerit dhe personi i kontaktit të institucionit të Agjencisë Kombëtare të Bregdetit, specialisti për burimet njerëzore.

Pasi u administruan dhe u trajtuan materialet shkresore, të vëna në dispozicion, rezultoi se:

- Në lidhje me rekomandimin e lënë për revokimin e akteve të deklarimit të statusit të punësimi, të cilat kanë dalë në kundërshtim me ligjin dhe ndërprerjen e marrëdhënies së punës për 5 punonjës, detyrë e cila i është lënë njësisë përgjegjëse (DAP) në pikën 2 të Vendimit, situata paraqitet si më poshtë:

Me shkresën nr. 405 prot., datë 19.01.2017, “Njoftim”, Departamenti i Administratës Publike informon Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil se në zbatim të rekomandimeve të vendimit objekt i këtij verifikimi, nuk rezultojnë më në këto pozicione pune:

- ***** Specialist në Sektorin e Zhvillimit Detar dhe Bregdetar në Agjencinë Kombëtare të Bregdetit;
- ***** , Specialist në Degën Rajonale Durrës, në Agjencinë Kombëtare të Bregdetit;
- ***** , Specialist në Degën Rajonale Durrës, në Agjencinë Kombëtare të Bregdetit;
- ***** , Përgjegjës Sektori në Drejtorinë e Planifikimit Territorial dhe Menaxhimit të Zonave Bregdetare, në Agjencinë Kombëtare të Bregdetit.

Me shkresën nr. 3067 prot., datë 10.06.2016 “Emërim”, të Departamentit të Administratës Publike drejtuar Agjencisë Kombëtare të Bregdetit dhe punonjësës ***** , bazuar në nenin 26 të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si edhe në Kreun III të Vendimit nr. 242, datë 18.03.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese”, e ka emëruar këtë nëpunës si nëpunës civil në pozicionin Titullar i Degës Rajonale Lezhë, në Agjencinë Kombëtare të Bregdetit – kategoria e pagës III-b. Referuar vërtetimit nr. 26 prot., datë 26.10.2016, të Kuvendit të Shqipërisë, rezulton se ***** , deri në datën 01.04.2014, ka qenë “nëpunës civil i kategorisë ekzekutive” (që prej vitit 2007), në pozicionin “specialist i lartë - redaktor”, me pagë të kategorisë III-b, në Shërbimin e Botimeve Parlamentare. Pra, momenti i hyrjes në

fuqi të ligjit, e ka gjetur këtë punonjëse në pozicion të shërbimit civil, prej më shumë se 1 viti, fakt i cili nuk ka qenë e mundur të konstatohet gjatë procesit të mbikëqyrjes në Agjencinë Kombëtare të Bregdetit.

Sa më sipër, kalimi i kësaj punonjëseje në pozicionin e Titullarit të Degës Rajonale Lezhë (me të njëjtën kategori page) nga Departamenti i Administratës Publike është kryer në respektim të nenit 26 të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si edhe në Kreun III të Vendimit nr. 242, datë 18.03.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese”.

- Për rregullimin e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil në rastin e punonjëses *****, nga ana e institucionit nuk është marrë asnjë masë për zbatimin e rekomandimeve të pikës 3 të vendimit të Komisionerit. Gjatë verifikimit në subjekt, rezulton se ky rast është duke u shqyrtuar në gjykatë, vërtetuar kjo me Kërkesën Ankimore Nr. 283/6 Prot., datë 14.06.2016, me kërkues Agjencinë Kombëtare të Bregdetit, kundër paditësit *****, objekti: “Kundërshtimi i Vendimit Nr. 80-2016-2739, datë 01.06.2016, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë”.

Në këto kushte, referuar nenit 36, të Kodit të Procedurës Civile, i cili sanksionon se: “Asnjë institucion tjetër nuk ka të drejtë të pranojë për shqyrtim një mosmarrëveshje civile që është duke u gjykuar nga Gjykata”, zbatimi i kësaj pike të vendimit nuk mund të ndiqet më tej nga ana e Komisionerit.

- Në zbatim të pikës 4 të vendimit të Komisionerit, nga këqyrja e akteve të administruara në dosjen individuale të çdo nëpunësi civil, rezulton se njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore të institucionit të mbikëqyrur i ka plotësuar dosjet e personelit të çdo nëpunësi civil, sipas detyrave të lëna në Raportin Përfundimtar të mbikëqyrjes.
- Në lidhje me detyrën që i është lënë njësisë së menaxhimit të burimeve njerëzore të institucionit të mbikëqyrur dhe njësisë përgjegjëse (DAP) në pikën 5 të vendimit, për plotësimin e dosjes së punonjësit *****, me të gjitha dokumentet që provojnë edukimin e tij arsimor, të tilla si “Diploma e shkollës së lartë, lista e notave” ose një dokument i barasvlershëm me diplomën, në formën e vërtetimit të lëshuar nga institucioni përkatës për arsimin e lartë, gjatë procesit të verifikimit, grupi i punës ka administruar në cilësinë e provës Vërtetimin Nr. 3279 Amzës, datë 16.05.2016, të Rektorit të Universitetit të Sporteve të Tiranës, me anë të të cilit vërtetohet se ***** ka përfunduar studimet e larta pa shkëputje nga puna (me korrespondencë) pranë Institutit të Lartë të Kulturës Fizike “Vojo Kushi” (sot Universiteti i Sporteve të Tiranës) gjatë periudhës 1993/1994-1999/2000, bashkëlidhur të cilit ndodhet edhe certifikata e notave.

Nga ana e grupit të punës është administruar edhe shkresa nr. 533/1 prot., datë 01.06.2016, “Kthim përgjigje”, e Rektoratit të UST, në të cilën, përveç sa më sipër, thuhet se: “Studentët të cilët kanë përfunduar studimet e larta pranë institucionit tonë në sistemin pa shkëputje nga puna (korrespondencë), kanë zhvilluar të njëjtin plan mësimor të sistemit me shkëputje nga puna (3 vite mësimore, 6 semestra) i shtrirë në 4

vite akademike. Në përfundim këta studentë janë të pajisur me diplomë “Mësues i Edukimit Fizik”.

Në pikën 4 të nenit 91 të ligjit nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, parashikohet sa më poshtë:

“4. Institucionet e arsimit të lartë nuk mund të lëshojnë dublikatë diplome, por mund të lëshojnë dokument të barasvlershëm me diplomën në formën e vërtetimit, i cili duhet të përmbajë emrin e institucionit që ka lëshuar diplomën, numrin e diplomës origjinale, datën e lëshimit të saj, ciklin dhe programin e studimit.”

Në analizë të sa më sipër, arrihet në përfundimin se as vërtetimi Nr. 3279 Amzës, datë 16.05.2016, i Rektorit të Universitetit të Sporteve të Tiranës dhe as shkresa nr. 533/1 prot., datë 01.06.2016, “Kthim përgjigje”, e Rektoratit të UST, nuk mund të konsiderohen dokumente të barasvlershme me diplomën, për shkak se asnjëra prej tyre nuk përmban numrin e diplomës origjinale dhe datën e lëshimit të saj.

Për sa u parashtrua më sipër, pas përfundimit të afatit për zbatimin e detyrave të lëna në Vendimin Nr. 101 datë 13.09.2016, “Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së përgjithshme në institucionin, Agjencia Kombëtare e Bregdetit”, të Komisionerit, rezulton se nga ana e njësisë së burimeve njerëzore të institucionit janë zbatuar pjesërisht rekomandimet e lëna në vendimin paralajmërues.

Në përfundim të procesit të verifikimit në subjekt, lidhur me ligjshmërinë e veprimeve administrative të kryera gjatë realizimit të procedurave për rekrutim, transferim, ngritje në detyrë, në institucionin e Agjencisë Kombëtare të Bregdetit, prej datës 01.03.2016 që është momenti i verifikimit të kryer në kuadër të mbikëqyrjes e në vazhdim, rezultoi se aktet e emërimeve në pozicionet e shërbimit civil janë nxjerrë nga njësi përgjegjëse, DAP, sipas parashikimeve të pikës 19, të kreut IV dhe pikës 22 të kreut VII, të Vendimit Nr. 243, datë 18.03.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”.

Për këto arsye:

Bazuar në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; ligjin nr. 44/2015 “Kodi i procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” dhe Rregulloren, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

VENDOSA:

1. Konstatimin e zbatimit të pjesshëm të rekomandimeve të Vendimit Nr. 101, datë 13.09.2016, “Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së përgjithshme në institucionin e Agjencisë Kombëtare të Bregdetit” nga ana e njësisë së menaxhimit të burimeve njerëzore të institucionit dhe njësisë përgjegjëse, Departamentit të Administratës Publike.
2. Verifikimin e mëtejshëm të pikës 2 të dispozitivit të Vendimit Nr. 101, datë 13.09.2016, për të cilën kërkohet reagimi i njësisë së menaxhimit të burimeve

njerëzore të institucionit dhe Njesisë Përgjegjëse, Departamentit të Administratës Publike.

3. Konstatimin e ligjshmërisë së veprimeve administrative, të kryera gjatë procesit të emërimeve nga institucioni i Agjencisë Kombëtare të Bregdetit, prej datës 01.03.2016 e në vazhdim.
4. Për këtë vendim të njoftohet institucioni i Agjencisë Kombëtare të Bregdetit, Departamenti i Administratës Publike, Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes dhe të informohet Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, në Kuvendin e Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera STRAKOSHA